

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës kërkon të punësojë një laborant me arsim të lartë.**

Kandidati për këtë vend pune duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në UPT:
  - Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
  - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
  - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (Elektronikë)
  - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
2. Të ketë njohuri në pajisje laboratorike që kanë të bëjnë me restaurimin dhe teknologjinë e arkitekturës (total station, skaner, etj.)
3. Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj perëndimore, e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi (preferohen gjuhët anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht).
4. Të ketë njohuri në programet Word, Excel, Auto CAD, Photoshop
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
6. Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vite në fushat që mbulon departamenti (DRTA)

**DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **27.12.2019** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diploma e studimeve universitare dhe lista e notave të noterizuara. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certifikatë kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (në rast se ka);
7. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar;
8. Raport mjekësor për aftësi në punë;
9. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi.
10. Dy letra referencash.

**II. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, kërkon të punësojë 1 (një) personel ndihmësakademik më karakter mësues (laborant) në Departamentin e Automatizimit, kandidati duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:**

1. Të jetë diplomuar në Inxhinieri Elektrike, drejtimi Automatizim i Industrisë, Master i Shkencave ose sistemi i vjetër.
2. Të ketë njohuri të mira kompjuterike të programeve bazë të kompjuterit (Word, Excel, Visio, PowerPoint etj.) si dhe programeve specifike inxhinierike, të përdorura në degën e Inxhinierisë Elektrike.
3. Të ketë aftësi komunikuese dhe bashkëpunimi.
4. Të zotërojë një gjuhë të huaj: anglisht, frëngjisht, italisht dhe spanjisht, e dëshmuar me certifikatën përkatëse si test ndërkombëtar.
5. Eksperienca në vende të tjera pune përbën përparësi.

**DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **27.12.2019** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diploma e studimeve universitare dhe lista e notave të noterizuara. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
6. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Certifikatë kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (në rast se ka);
8. Dëshmi e gjuhës së huaj e noterizuar;
9. Raport mjekësor për aftësi në punë;
10. Formular vetëdeklarimi.